

NJOFTIM PËR SHTYP

MBI PËRZGJEDHJEN E PESË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE TË CILAT DO TË KRYEJNË VERIFIKIMIN PARAPRAK TË KANDIDATURAVE PËR ANËTARIN QË PËRFAQËSON SHOQËRINË CIVILE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

Më datë 20 shtator 2023, ora 15.00, në ambjentet e institucionit të Avokatit të Popullit u zhvillua mbledhja e dytë e organizatave të shoqërisë civile që plotësojnë kriteret ligjore për të qenë pjesë e komisionit të shoqërisë civile.

Prezent në këtë takim ishin përfaqësuesit e organizatave të mëposhtme:

- ✓ Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim"
- ✓ Qendra "Qëndresa Qytetare"
- ✓ Fondacioni "Kontribut për Edukim"
- ✓ Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm
- ✓ Qendra për Çështjet e Informimit Publik "Infoçip"
- ✓ Shoqata "Drejtësia Sociale"
- ✓ Klinika Ligjore "Wisdom"

Ndërkohë që nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë nuk mori pjesë asnjë përfaqësues.

Qëllimi i këtij takimi ishte zhvillimi i procedurave për përzgjedhjen me votim të fshehtë të organizatave që do jenë anëtarë të komisionit të shoqërisë civile. Në përputhje me procedurat e parashikuara nga nenet 56 dhe 154 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, pas përfundimit të procesit të votimit pesë organizatat që morën më shumë vota ishin si më poshtë:

- ✓ Qendra "Qëndresa Qytetare"
- ✓ Shoqata "Drejtësia Sociale"
- ✓ Klinika Ligjore "Wisdom"
- ✓ Fondacioni "Kontribut për Edukim"
- ✓ Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm

Organizatat e mësipërme të përzgjedhura si anëtarë të komisionit të shoqërisë civile zgjodhën si kryetar të këtij komisioni z. Gentian Serjani, përfaqësues i shoqatës "Drejtësia Sociale".

Komisioni i shoqërisë civile vendosi që mbledhja e parë e tij të zhvillohet ditën e martë, më datë 26 shtator 2023, ora 09.30, pranë ambjenteve të institucionit të Avokatit të Popullit.